



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:094885

Datë: 02.12.2024

Numri i dokumentit: 06534071

P.nr.599/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Bujar Ahmeti, në çështjen penale kundër të pandehurit N.K nga P, rruga "...", nr..., për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit, nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës me kërkesë për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3336/23, e datës 15.03.2024, jashtë seance më datë 02.12.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorit të Shtetit, PP.II.nr.3336/23, e datës 15.03.2024, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPP-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

N. K, nga i ati H dhe nëna A, e vajzërisë L, i lindur më datë ..., në fashtin D, me vendbanim në P, rruga "...", nr... i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 19.04.2023, rreth orës 19:30, në vendin e quajtur "...", në regjionin E.P. të D, Z.K e P, i pandehuri N.K me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, pa lejen paraprake nga organi i autorizuar, e dëmtuara Drejtoria e Inspeksionit, Sektori i Pylltarisë në Prishtinë, në pyllin publik ka prerë me motor sharrë drunjtë dhe atë 39 copë drurë të llojit Ahu, me diametër në lartësi 1.30 centimetra dhe me vëllim të përgjithshëm 2.70 m³, të cilat me qëllim të transportimit të tyre, ka pasur për ti ngarkuar në kamionetën e tij me targa 06-844-AS, me ç'rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në vlerën prej 345.60 euro.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale *vjedhja e pyllit, nga neni 349 par.1 të KPRK-së*. Andaj, gjykata konform neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, të KPRK-së, si dhe neneve 364 dhe 495 të KPP-së, të pandehurit i shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

- I. Në shumën prej **300 € (treqind euro)**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës, do t'i caktohet 1 (një) ditë burgim.
- II. Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës Drejtoria e Inspeksionit, Sektori i Pylltarisë në Prishtinë, në emër të kompensimit të dëmit, të paguaj shumën prej 345.60 € (treqind e dyzet e pesë euro e gjashtëdhjetë cent) në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- III. Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), si dhe shumën prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.3336/23, e datës 15.03.2024, kundër të pandehurit N.K, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit, nga neni 349 par.1 të KPRK-së dhe njëherit ka propozuar që ndaj të njëjtit të jepet urdhrë ndëshkimor dhe t'i shqiptohet dënim me gjobë, me arsyetimin se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, që vërtetojnë faktin se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Gjyqtari i çështjes me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes në kuptim të nenit 493 të KPP-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPP-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrë ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të të cilave vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si fletëparaqitja e rojës së pyllit e datës 19.04.2023, foto dokumentacioni, procesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurin N. K i datës 14.03.2024, të dhënë në polici, si dhe shkresat tjera të lëndës, të gjitha këto janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe rrjedhimisht bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë ashtu siç është propozuar nga prokurori i shtetit në kërkesën për dhënien e urdhrë ndëshkimor, mund të arrihen qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së.

Vendimin për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar, gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u mor konform nenit 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPP-së, ndërkaq vendimi për shumën e të hollave në

emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave është marrë konform nenit 36 par.3, nënpar.3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 364 dhe 495 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.599/24 datë 02.12.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Bujar Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të tij. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.